

RRJEDHA TË ARSIMIT SHQIP NË KOMUNËN E KLINËS

Përpyjekjet e para-zanafilla

Si në krejt Kosovën, edhe në komunën e Klinës përpyjekjet për hapjen e shkollave shqipe kanë filluar shumë herët. Në vitin 1897 në Zllakuqan të Klinës hapet njëra ndër shkollat e para shqipe, dhjetë vjet pas shkollës së Korçës, me iniciativën dhe kontributin e veçantë të Atë Shtjefën Gjeçovit. Dyert e kësaj shkolle u hapën përsëri gjatë Luftës së Dytë Botërore nga mësuesi Ndrecë Ndue Gjoka, i cili bënte pjesë në mesin e qindra mësuesve shqiptarë që ia mësynë Kosovës për të përhapur dritën e shkollës shqipe në shumë qytete dhe fshatra, sipas vendimit të Ministrit të atëhershëm të Arsimit, Ernest Koliqit.

Mes dy luftërave botërore në komunën e Klinës kanë funksionuar shkolla e Zllakuqanit, Kijevës, Budisalcit, Pograxhës, Drenocit, Dollcit dhe Klinës, mirëpo mësimi në këto shkolla zhvillohej në gjuhën e shtetit okupes

Pas Luftës së Dytë Botërore mësimi vazhdoi në shkollën e Zllakuqanit, Kijevës, të Carallukës, Klinës, Ujmirit, Dollcit, Drenocit, Jashanicës etj. Mësimi zhvillohej edhe nëpër oda të fshatrave të ndryshme të komunës. Në këtë kohë numri i mësuesve dhe nxënësve ishte simbolik, por puna nëpër këto shkolla kishte rëndësinë e vet, sepse zvogëlohej shkalla e lartë e analfabetizmit. Edhe në komunën e Klinës kuadrot e para të arsimit shqip pas Luftës së Dytë Botërore erdhën nga Normalja e Elbasanit, Prishtinës, Pejës dhe Gjakovës.

Pas ndryshimit të rrethanave shoqërore më 1968, edhe për arsimin klinas u krijuan kushte më të favorshme. Në këtë vit në Klinë u hapën klasat e para të gjimnazit, si paralele e gjimnazit “11 Maji” të Pejës. Drejtor i parë ishte profesor Frrok Gojani që bëri shumë për përfshirjen e nxënësve në shkollimin e mesëm. Një vit më vonë gjimnazi pavarësohet dhe emërtohet me emrin e Luigj Gurakuqit. Në të njëjtën kohë u hapën edhe paralelet e kësaj shkolle në Kijevë. Këto dy shkolla ndikuan shumë në shkollimin dhe emancipimin e rinisë si dhe krijuan parakushte që komuna e Klinës të ketë më shumë kuadro të fushave të ndryshme shoqërore, shkencore dhe ekonomike. Si në krejt Kosovën, gjatë kësaj kohe arsimit klinas shënoi rezultate dhe kthesa pozitive dhe kjo vazhdoi deri kah fundi i viteve tetëdhjetë dhe fillimi i viteve nëntëdhjetë, kur Serbia ndërmoi masa drastike dhe bëri segregacion në arsim, duke iu përgjigjur në këtë mënyrë kërkesave të shqiptarëve për të drejtat dhe liritë e tyre njerëzore dhe kombëtare.

Drejt epilogut-paraluftra, lufta

Vitet nëntëdhjetë arsimin klinas e vunë para sprovave të rënda për ta vazhduar punën që kishte filluar para shumë vjetësh dhe kishte dhënë rezultate për zhvillimin e komunës dhe jo vetëm të saj. Mësuesit tanë refuzuan të punonin me planprogramet mësimore të Serbisë dhe si pasojë e

kësaj organet shtetërore dhe policore serbe në vitin shkollor 1991/1992 ua mbyllën dyert mijëra nxënësve të shkollës së mesme dhe arsimtarëve të tyre. Mirëpo as tash kontinuiteti i mësimi nuk u ndërpre. Arsimtarët dhe nxënësit e shkollës së mesme të Klinës vazhduan punën nëpër punkte: në katër shtëpi-shkolla në Zllakuqan, në dy shtëpi-shkolla në Zajm, në dy shtëpi-shkolla në Përlina, në tri shtëpi-shkolla në Grabanicë, në objektin e shkollës fillore në Gllarevë, Zajm, Sverrkë dhe Ujmirë. Mësimi zhvillohej nën kushte të rënda të okupimit. Milicia serbe pengonte procesin mësimor, i ndiqte arsimtarët dhe nxënësit nga shkolla, i maltretonte, i burgoste. Ishte vështirësuar jeta në çdo segment të saj, prandaj lindi nevoja e organizimit dhe e fillimit të luftës së armatosur. Shumë arsimtarë dhe nxënës të shkollave tona iu bashkuan radhëve të Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Disa ranë dëshmorë të kombit, siç janë mësuesi dëshmor Avni Zhabota dhe Ali Krasniqi, me emrat e të cilëve janë emërtuar shkolla e Shtupelit dhe ajo e Ujmirit. Gjatë luftës u vranë 10 punëtorë të arsimit dhe 22 nxënës, kurse në listat e të zhdukurve figurojnë emrat e 2 arsimtarëve dhe 22 nxënësve. Regjimi i Millosheviqit me ushtrinë, policinë dhe paramilitarët serbë dogji e shkatërroi shumicën e shkollave të komunës, përfshirë dokumentacionin pedagogjik dhe çdo gjë tjetër. Edhe gjatë luftës mësimi shqip, si pjesë e luftës për çlirim, vazhonte në ato shkolla ku krijoheshin sadopak kushte, dhe shumica e arsimtarëve ishin luftëtarë të UÇK-së. Luftë e gjithëmbarshme. Me pushkë e me penë.

Fillimi i ri-paslufta

Arsimin shqip në komunën tonë pas luftës e pritën vështirësi të shumta siç janë mungesa e objekteve shkollore dhe e hapësirave të tjera për punë. Në disa shkolla mësimi zhvillohej nëpër tenda, siç janë shkolla e Gllarevës dhe ajo e Gremnikut. Pas angazhimit të strukturave komunale, KFOR-it, UNMIK-ut dhe donatorëve nga jashtë dhe të atyre të brendshëm filloi ndërtimi i objekteve shkollore, gjë që ndikoi në krijimin e kushteve më të mira për një mësim cilësor dhe bashkëkohor. Deri në vitin 2004 u ndërtuan 7 objekte të reja shkollore dhe tri anekse dhe meremetimi i 19 objekteve shkollore. Kemi rregulluar infrastrukturën shkollore dhe ambientet. Shkollat janë pajisur me mjete të nevojshme mësimore dhe mjete të tjera pune. Vlera e përgjithshme e investimeve në arsimin e Klinës, përfshirë donacionet dhe grantet qeveritare nga buxheti i konsoliduar i Kosovës, arrin shifrën 4.500000€

Rrjeti shkollor

Komuna e Klinës ka 26 shkolla fillore (15 amë, 11 paralele); 2 shkolla të mesme (gjimnazi “Luigj Guirakuqi” dhe shkolla e mesme profesionale “Fehmi Agani”); Kopshtin e fëmijëve “Xhevë Lladrovci” në qytetin e Klinës.

Në vitin shkollor 2007/2008, në të gjitha nivelet e arsimit, përfshirë edhe dy paralelet me nxënës me nevoja të veçanta, vijuan 10560 nxënës, të shpërndarë në 419 paralele. Në Kopshtin e fëmijëve janë 41 fëmijë (prej moshës një deri në pesëvjeçare, të përfshirë në grupe sipas grupmoshës); fëmijë në nivelin parafillorë janë 436; nxënës në nivelin 1 ose në shkollën e mësimi të obliguar (klasa I-V) janë 4498; në nivelin 2 (klasa VI-IX) 4001 nxënës; në nivelin 3 (klasa X-XIII) 1566 nxënës. Në të gjitha institucionet edukativo-arsimore punojnë 655 punëtorë (të gjitha llojet e personelit), prej të cilëve femra janë 27%. Nga numri i përgjithshëm i nxënësve në nivel komunal femra janë 46.54%. Në shkollat nëntëvjeçare femra janë 47.60% (vitin e kaluar shkollor ishin 36.84%); në shkollat e mesme të larta janë 40.22% femra (në

gjimnaz 56.30%, në SHMP 20.02%). Suksesi pozitiv i nxënësve në fund të vitit shkollor 2006/2007 në nivel komunal ishte 65.75% (më 2005/2006 ky sukses ishte 62.90%).

Infrastruktura, mjetet didaktike, nevojat

Numri i objekteve dhe infrastruktura shkollore në përgjithësi krijojnë hapësirë dhe kushte për zhvillimin normal të procesit mësimor. Vështirësi paraqet mungesa e objektit të shkollës së mesme profesionale "Fehmi Agani" në Klinë, nxënësit dhe punëtorët e së cilës shkollë punojnë në objektin e gjimnazit "Luigj Gurakuqi". Projekti për ndërtimin e objektit të shkollës së mesme profesionale bën pjesë në numrin e projekteve që ka përgatitur Komuna e Klinës për Konferencën e donatorëve. Nga tërësia e sipërfaqes së hapësirës së objekteve shkollore, një nxënësi i takojnë 2.87 m.

Edhe pse çdo shkollë ka kompjuterë, të gjitha shkollat nuk kanë kabinete të informatikës dhe laboratorë të shkencave ekzakte. Vetëm në shkollën fillore "Ismet Rraci" në Klinë dhe në Gjimnaz funksionojnë bibliotekat shkollore, të cilat kanë nevojë për furnizim me literaturë shkollore dhe pedagogjike.

Sikur në qendra të tjera të Kosovës, edhe në arsimin e komunës së Klinës janë realizuar disa projekte nga Projekti i Bankës Botërore PPPA (Programi për përmirësimin e pjesëmarrjes në arsim). Realizimi i këtyre projekteve ka ndikuar dukshëm në përmirësimin e infrastrukturës shkollore dhe të ambientit, në ngritjen e cilësisë së mësimdhënies e të mësimnxënies në shkollat ku është realizuar projekti e sidomos në shkollat që kanë përfituar kabinete të Informatikës ("Motrat Qiriazit", Gllareva, Grabanica, Budisalci, Drenoci), sepse në këto shkolla mund të shfrytëzohen pajisjet edhe për punën në lëndë të tjera mësimore. Nga Projekti PPPA në komunën e Klinës kanë përfituar 12 shkolla, janë realizuar 13 projekte të rëndësishme. Shuma e përgjithshme e grantit të Bankës Botërore është 87234 € shuma e kontributeve të tjera është 26346 € Shuma e përgjithshme 113580€ Projektet janë realizuar brenda viteve 2004-2006, kur përfundoi pjesa e parë e Programit të BB-së për investim në arsimin e Kosovës. Me mjete kabinetike dhe rregullimin e infrastrukturës shkollore arsimin e Klinës e kanë ndihmuar edhe KFOR-i italian dhe KFOR-i sloven.

Drejtoria komunale e arsimit dhe kulturës, synimet

Personelin e Drejtorisë së arsimit dhe kulturës e përbëjnë pesë veta: drejtoresha dhe katër zyrtarë. kemi nevojë për një zyrtar juridik dhe për një zyrtar të infrastrukturës. Mirëpo, DAK-ja në Klinë bën përpjekje të vazhdueshme që të jetë në shërbim të nxënësve, arsimtarëve, qytetarëve dhe organeve më të larta shtetërore të administratës dhe arsimit, duke qenë në krye të tealizimit të detyrave dhe të përgjegjësive që dalin nga Ligji dhe të gjitha aktet e tjera normative, Rregullorja 2007/30 dhe të gjitha Udhëzimet administrative të MASHT-it që kanë të bëjnë me zbatimin e politikave arsimore, me përhapjen dhe promovimin e të gjitha strategjive që ndihmojnë për avancimin e mëtejshëm të metodologjive të mësimdhënies, në mënyrë që nxënësi ynë të jetë në gjendje sot e nesër t'i përballojë sfidat e zhvillimit shkencor e teknologjik.

Synimet kryesore:

- Përfshirja e të gjithë fëmijëve në nivelet e shkollimit, pa asfarë dallimesh
- Zgjerimi i hapësirave shkollore
- Krijimi i bibliotekave shkollore
- Pajisjet kabinetike dhe qasja në Internet
- Trajnimi i përhershëm i personelit mësimdhënës
- Arsimimi i të rriturve në harmoni me idenë e të mësusrit gjatë gjithë jetës
- Zhvillimi i arsimit profesional dhe atij joformal në harmoni me kërkesat e tregut dhe të zhvillimit ekonomik të komunës.

Mund të na kontaktoni

Drejtoreshë Tushë Mehmetaj, tel 044 966 439

Hajdin Morina, tel

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

Suksesi i nxënësve në fund të gjysmëvjetorit të dytë 2007/08

Arsimi fillor (1-

5)

Komuna

Klinë

Klasa	Nr. paraleleve	Nr. nxënësve	Suksesi pozitiv										Gjithsej me nota negative që përcillen		Të pa notuar		Numri i mungesave		
			Shkëlqyeshëm		Sh. mirë		Mirë		Mjaftueshëm		Gjithsej me nota pozitive						Të arsyeshme	Të paarsyeshme	Gjithsej
			Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%					
1	39	987	554	56.13	188	19.05	126	12.77	79	8.004	947	95.95	15	1.52	25	2.533	4523	2984	7507
2	38	939	502	53.46	175	18.64	140	14.91	102	10.86	919	97.87	8	0.852	12	1.278	3307	1865	5172
3	33	712	363	50.98	135	18.96	121	16.99	76	10.67	695	97.61	7	0.983	10	1.404	2580	2156	4736
4	37	880	465	52.84	165	18.75	145	16.48	89	10.11	864	98.18	10	1.136	6	0.682	2990	1990	4980
5	38	930	444	47.74	186	20	169	18.17	104	11.18	903	97.1	12	1.29	15	1.613	4914	3213	8127
GJ	185	4448	2328	52.34	849	19.09	701	15.76	450	10.12	4328	97.3	52	1.169	68	1.529	18314	12208	30522

Suksesi i nxënësve në fund të gjysmëvjetorit të dytë 2007/08

Arsimi i mesëm i ulët (6-9)

Komuna Klinë

Klasa	Nr. paraleleve	Nr. nxënësve	Suksesi pozitiv										Suksesi i pamjaftueshëm								Të pa notuar		N	
			Shkëlqyeshëm		Sh. mirë		Mirë		Mjaftueshëm		Gjithsej me nota pozitive		Përcillen në riprovim						Përsërisin klasën					
													Me 1 notë të pamjaftueshme		Me 2 nota të pamjaftueshme		Me 3 nota të pamjaftueshme							
			Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%				
6	36	899	343	38.15	144	16.02	172	19.13	144	16.02	803	89.32	25	2.8	33	3.7	16	1.8	6	0.667	16	1.78	86	
7	41	973	306	31.45	164	16.86	243	24.97	121	12.44	834	85.71	18	1.8	53	5.4	27	2.8	11	1.131	30	3.083	80	
8	41	1037	359	34.62	209	20.15	217	20.93	120	11.57	905	87.27	26	2.5	49	4.7	21	2	12	1.157	24	2.314	115	
9	41	1058	392	37.05	228	21.55	244	23.06	149	14.08	1013	95.75	6	0.6	8	0.8	5	0.5	4	0.378	22	2.079	113	
GJ	159	3967	1400	35.29	745	18.78	876	22.08	534	13.46	3555	89.61	75	1.9	143	3.6	69	1.7	33	0.832	92	2.319	396	

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

Suksesi i nxënësve në fund të gjysmëvjetorit të dytë 2007/08

Arsimi i mesëm i lartë (10-13)

Komuna Klinë

Klasa	Nr. paraleleve	Nr. nxënësve	Suksesi pozitiv										Suksesi i pamjaftueshëm						Të pa notuar				Numri i mungesave		
			Shkëlqyeshëm		Sh. mirë		Mirë		Mjaftueshëm		Gjithsej me nota pozitive		Përcillen në riprovim				Përsërisin klasën						Të arsyeshme	Të paarsyeshme	Gjithsej
			Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Me 1 notë të pamjaftueshme		Me 2 nota të pamjaftueshme		Nr	%	Nr	%			
															Nr	%	Nr	%					Nr	%	Nr
10	17	497	132	26.56	76	15.29	67	13.48	21	4.225	296	59.56	36	7.24	109	22	45	9.1	11	2.2	6734	6522	13256		
11	18	440	92	20.91	80	18.18	72	16.36	16	3.636	260	59.09	39	8.86	114	26	18	4.1	9	2	6359	4945	11304		
12	19	412	108	26.21	83	20.15	77	18.69	25	6.068	293	71.12	33	8.01	81	20	1	0.2	4	1	5054	3903	8957		
13	6	114	25	21.93	29	25.44	21	18.42	0	0	75	65.79	14	12.3	24	21	0	0	1	0.9	2057	1210	3267		
GJ	60	1463	357	24.4	268	18.32	237	16.2	62	4.238	924	63.16	122	8.34	328	22	64	4.4	25	1.7	20204	16580	36784		

**Rezultatet e Testit nacional të klasës IX, mbajtur më 20 qershor 2008.
Nga 1067 nxënës u testuan 941.Shkalla e kalueshmërisë bazohet në 40% të pikëve.**

Emri i shkollës	Nr. i pa.	Hynë në testim	Kaluan	% e kalueshmërisë
1. Sh.fill."Ismet Raci"-Klinë	7	210	191	90.95
2. Sh.fill."Emin Duraku"-Sferrkë	5	101	59	58.41
3. Sh.fill."A.Sh.Gjeçovi"-Zllakuqan	3	66	60	90.90
4. Sh.fill."Tre dëshmorët"-Jashanicë	3	71	44	61.97
5. Sh.fill."D. e Qëndresës"-Gillarevë	4	92	76	82.60
6. Sh.fill."Azem Bejta"-Grabanicë	3	63	46	73.01
7. Sh.fill."Isa Boletini"-Drenoc	1	35	25	71.42
8. Sh.fill."Esad Mekuli"-Cerovik	3	64	26	40.62
9. Sh.fill."Ali Krasniqi"-Ujmirë	3	64	62	96.87
10. Sh.fill."Avni Zhabota"-Shtupel	1	16	16	100
11. Sh.fill."Motrat Qiriazi"-Klinë	3	70	67	95.71
12. Sh.fill."Nënë Tereza"-Budisalc	1	10	10	100
13. Sh.fill. "A.Gj.Fishta"-Jagodë	1	20	12	60
14. Sh.fill."Ymer Berisha"-Siqevë	1	20	20	100
15. Sh.fill."Zgjimi"-Gremnik	2	39	31	79.48
Arritshmëria në shkallë komune	41	941	745	79.17

**Rezultatet e provimit të maturës-gjinnazi "Luigj Gurakuqi"-afati i qershorit (7.6.2008)-Qendra e testimit:
sh.f. "Ismet Rraci" Klinë**

Shkencat shoqërore		Shkencat natyrore		Gj.i përgjithshëm		Gj.mat.-informatikë		Shënime të përmbledhura		
U testuan	Kaluan	U testuan	Kaluan	U testuan	Kaluan	U testuan	Kaluan	Nxënës që hynë në provim	Kaluan	% e kalueshmërisë së përgjithshme
68	22 ose 32.35%	94	67 ose 71.27%	55	31 ose 56.36%	27	9 ose 33.33%	244	129	52.86%

Rezultatet e provimit të maturës-afati i qershorit (7.6.2008)-Qendra e testimit: sh.f. "Ismet Rraci" Klinë	
SHMP "Fehmi Agani"	
U testuan	Kaluan
42	2 ose 4.76%

Pas vendimit të MASHT-it për uljen e kriterit të kalueshmërisë prej 50 në 45 pikë

Rezultatet e provimit të maturës-gjinnazi "Luigj Gurakuqi"-afati i qershorit (7.6.2008)-Qendra e testimit: sh.f. "Ismet Rraci" Klinë
--

Shkencat shoqërore		Shkencat natyrore		Gj.i përgjithshëm		Gj.mat.-informatikë		Shënime të përmbledhura		
U testuan	Kaluan	U testuan	Kaluan	U testuan	Kaluan	U testuan	Kaluan	Nxënës që hynë në provim	Kaluan	% e kalueshmërisë së përgjithshme
68	41 ose 60.29	94	72 ose 76.59%	55	43 ose 78.18%	27	14 ose 51.85%	244	170	69.67%

Rezultatet e provimit të maturës-afati i qershorit (7.6.2008)-Qendra e testimit: sh.f. "Ismet Rraci" Klinë	
SHMP "Fehmi Agani"	
U testuan	Kaluan
42	10 ose 23.80%